

≡ PESË LIRITË ≡ E KAFSHËVE

Çdo kafshë **nën përkujdesjen e njeriut varet tërësisht nga njeriu** për mbijetesë dhe mirëqenie të duhur. Prandaj njeriu duhet të përkujdeset që kafshës t'i sigurohet mirëqenia dhe shëndeti i plotë.

Mirëqenia e kafshës nënkupton cilësinë e jetës së një kafshe dhe ndikohet nga shëndeti fizik dhe mendor i saj.

Kafshët kanë mirëqenie të mirë kur janë në gjendje të përjetojnë ndjenja pozitive dhe kur janë të lira të shprehin sjelljet e tyre të natyrshme dhe kur nuk vuajnë nga shëndeti i dobët fizik dhe ndjenjat negative si dhimbja, shqetësimi, uria, etja, frika dhe frustrimi.

**KAFSHËT QË JANË TË SHËNDETSHME,
NUK KANË DHIMBJE, JETOJNË NË REHATI
DHE PA STRES, KANË MIRËQENIE TË LARTË.**

Mënyra më e mirë për t'u siguruar që kafshët kanë mirëqenie të lartë është **përdorimi i PESË LIRIVE** si standarde për plotësimin e nevojave të kafshëve.

PESË LIRITË janë standarde të përkujdesjes së kafshëve të pranuar ndërkombëtarisht që afirmojnë të drejtën e çdo qenie të gjallë për trajtim human dhe të dinjitetshëm.

Këto standarde u zhvilluan nga **Këshilli Britanik i Mirëqenies së Kafshëve në Ferma** në vitin 1965, dhe tashmë përdoren si bazë kryesore nga profesionistë dhe organizata ndërkombëtare të mirëqenies së kafshëve në mbarë botën, përfshirë edhe **Organizatën Botërore për Shëndetin e Kafshëve (WOAH)**.



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve
Animal Rights Foundation
Fondacija za prava životinja

5

LIRITË E KAFSHËVE

LIRIA NGA SHQETËSIMI

duke siguruar një mjedis të përshtatshëm, që përfshin strehimin dhe një zonë të rehatshme pushimi për kafshën.

Kjo do të thotë që kafshëve duhet t'u sigurohet shtrat i butë për fjetje dhe pushim, temperaturë e përshtatshme, nivele jo shqetësuese të zhurmës dhe qasje në dritë natyrale për kafshët.

Nëse kafsha mbahet në ambient të jashtëm, duhet të ketë strehë dhe mbrojtje nga elemente të ndryshme si moti dhe kafshët tjera, si dhe enë të përshtatshme me ushqim dhe ujë që nuk mund të rrëzohen dhe përmbysen.

LIRIA PËR TË SHPREHUR SJELLJE NORMALE



duke siguruar hapësirë të mjaftueshme për lëvizje dhe lojë, ambient të duhur dhe shoqëri me kafshë të tjera të llojit të njejtë.

Kafshët duhet të jenë në gjendje të ndërveprojnë - ose të shmangin - kafshët tjera të llojit të tyre, sipas dëshirës. Kafshët duhet të jenë në gjendje të zgjasin çdo pjesë të trupit të tyre (nga hunda në bisht), të vrapojnë, të kërcëjnë dhe të luajnë.

LIRIA NGA URIA DHE ETJA



duke u ofruar kafshëve qasje të vazhdueshme në ujë të freskët dhe dietë të mirëfilltë për të ruajtur shëndetin dhe energjinë.

Kjo duhet të jetë specifike për llojin e kafshës. Për shembull, këlyshët, qentë e rritur, kafshët shtatzëna dhe kafshët e moshuara kanë nevojë për lloje të ndryshme të ushqimit, të ofruara në orare të ndryshme.

LIRIA NGA DHIMBJET, LËNDIMI OSE SËMUNDJET



përmes parandalimit ose diagnostikimit dhe trajtimit të shpejtë mjekësor veterinar.

Kjo përfshin vaksinimin e kafshëve, mbikëqyrjen e kafshëve, shëndetin fizik, trajtimin e çdo lëndimi dhe sigurimin e medikamenteve të duhura.

LIRIA NGA FRIKA DHE SHQETËSIMI



duke siguruar kushte dhe trajtim që shmang vuajtjet mendore. Shëndeti mendor i një kafshe është po aq i rëndësishëm sa shëndeti i saj fizik, pasi stresi psikologjik mund të kalojë shpejt në sëmundje fizike. Këto kushte mund të arrihen duke siguruar mjedis kualitativ dhe hapësira të sigurta për t'u fshehur.